



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.1131/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevi anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar Komune 2017- Rivotim, të mbajtura me datë 17.12.2017, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 19.12.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, me shenjë ZL.Anr.1131/2017, e datës 18.12.2017, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar Komune 2017- Rivotim, të mbajtura me datë 17.12.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 18.12.2017, ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, me të cilën ka pretenduar se Demokracia në Veprim ka raportuar se në fshatin Prigodë në vendvotimin 0615C/01D ka pasur rast të votimit të dyfishtë. Po ashtu, ka kërkuar nga PZAP që të mundësoj hapjen e kutisë 0615/01D dhe të hetohet gjithë materiali senzitiv dhe të rinumërohet kjo kuti e votimit. Ankesës i ka bashkangjitur një letër të printuar, artikull të publikuar në portalin e Gazetës Express nga Demokracia në Veprim lidhur me votimin e dyfishtë.

PZAP-i, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe provave të bashkangjitura në ankesë gjeti se parashtruesi në ankesë me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar pretendimet e tij. Paneli vlerëson se shkimi i shkruar në portalin e Gazetes Express lidhur me të gjeturat në procesin e votimit në Komunë e Istogut gjatë ditës së votimit me dt.17.12.2017 nga Demokracia në Veprim (DNV) nuk paraqet provë në bazë të së cilës mund të konstatojmë se kemi të bëjmë me shkelje të cilat minojnë integritetin e zgjedhjeve. Po ashtu Demokracia në

Veprim ndonëse ka qenë e certifikuar për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe e njëjta ka mundur të paraqes në PZAP të gjeturat-shkeljet përmes ankesës, por një gjë të tillë nuk e ka bërë, andaj raportimet e publikuara në media nuk mund të merren si prova në bazë të cilave mund të vendoset se ka pasur parregullsi.

Për më tepër parashtruesi i ankesës nuk i ka plotësuar asnjë kusht ligjor që kërkohet me dispozitë ligjore të nenit 5 paragrafi 7 pika c e Rregullës nr.02/2015 të PZAP-së, në të cilën përcaktohet se: “Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzimet se ku mund të gjenden dëshmitë, në rast kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit”.

Prandaj paneli ankesën e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së dhe nenit 5 paragrafi 7 pika c e Rregullës nr.02/2015 të PZAP-së. Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave, dëshmive konkrete si dhe mungesës së udhëzimeve se ku mund të gjenden dëshmitë ankesës të ankuesit e refuzoj si të pa bazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 115, 117 dhe 118 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj, Paneli nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Librin e Votimit, dhe libri-lista e votuesëve nuk ka gjetur asnjë parregullsi apo ndërhyrje në këto materiale zgjedhore për vendvotimet e lartcekura, nga krahasimi i shënimeve për personat të cilët kanë votuar me asistencë, me të dhënat e tyre nga Lista e votuesëve, rezulton se personat të cilët kanë votuar me asistencë kanë qenë votues të shtyrë në moshë, ndërsa në librin e votimit nuk ka pasur asnjë vërejtje.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.Anr.1131/2017 më datë 19.12.2017

Kryesuese e Panelit
Fejzullah Rexhepi



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*